

JAVA E INOVACIONIT



HYRJE

Java e inovacionit është aktivitet një javorë i organizuar Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike (MIAP) që prej vitit 2014. Kjo javë i drejtohet kryesisht qytetarëve, informimit të tyre mbi risitë dhe teknologjitë në sektorë të ndryshëm. Njëkohësisht kjo javë synon gjithashtu të promovojë nisma inkurajuese për të rinjtë, duke nxitur ata në ideimin e projekteve inovative.

Në vazhdim të këtij dokumenti do të gjeni një përmbledhje të “Javës së inovacionit” të vitit 2015 dhe vitit 2014.

JAVA E INOVACIONIT 2015



Java e Inovacionit 2015 është mbyllur sot pasdite me ceremoninë e ndarjes së çmimeve të “Start Up Live Tirana”. Ky është një event që zhvillohet për të katërtin vit radhazi nga shoqata “UNIQUE Junior Enterprise”. Në dy vitet e fundit, eventi ka pasur mbështetjen e drejtpërdrejtë të Ministres së Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, znj. Milena Harito.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Ministrja Harito është shprehur: “Është vërtetë kënaqësi që po e mbyllim Javën e Inovacionit 2015 me këtë aktivitet, që është një aktivitet Live, ku ju keni punuar për më shumë se 48 orë në këtë fundjavë të nxehtë. Nga mentorët tuaj mësova se keni qenë shumë aktivë; ka pasur shumë ide dhe madje shumë më të arrira se vitin e kaluar. Ky është dhe objektivi ynë, pasi ne kërkojmë që, nga stadi i ideve, të kalojmë në projekte të zbatueshme dhe më pas në kthimin e tyre në biznese të suksesshme. Shpresoj shumë që idetë fituese edhe nëpërmjet fituesve, edhe nëpërmjet çmimeve që kemi përgatitur për ju, të bëhen shumë shpejt biznese të suksesshme dhe të japin fryte për ju dhe të gjithë ata që do punojnë me ju. Uroj që vitin tjetër të jemi dyfish më shumë dhe kjo është një sfidë për të gjithë ne”.

Duke iu referuar aktiviteteve të Javës së Inovacionit, ministrja Harito tha: “Java e Inovacionit 2015 ka qenë një javë e mbushur me aktivitete. Disa prej jush kanë marrë pjesë në të që nga fillimi, nga konferenca e OSCAL, në TEDx Tirana, në konferencën për Telekomunikacionin, në konferencën për sektorin bankar, si dhe në të tjera kompeticione siç ishin ICT Awards, çmimi i dhënë nga Deutsche Telekom etj. Me ndihmën tuaj shpresojmë që vitin tjetër të kemi një javë Inovacioni edhe më të ngjeshur, edhe më të suksesshme dhe, pse jo, ta zgjasim në më shumë se një javë”.

“Start Up Live Tirana” ka një format global dhe këtë vit rreth 90 të rinj prezantuan idetë e tyre inovatore përpara një jurie të përbërë nga manaxherë dhe drejtues biznesesh të mëdha në vend. Juria përbëhej nga përfaqësuesit e “Raiffeisen Bank”, Agjencisë Rajonale të Zhvillimit, Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Kompanisë “duapune.com” dhe Agjencisë Shqiptare të Teknologjisë së Informacionit.

Të rinjtë pjesëmarrës, për tri ditë me radhë, kanë punuar për realizimin në praktikë të ideve të tyre, të mbikëqyrur dhe të ndihmuar nga mentorët përkatës. Në përfundim ata kanë bërë prezantimin e ideve tashmë të realizuara dhe të gatshme për t’iu prezantuar publikut, por edhe përfaqësuesve të biznesit, të cilët mund t’i bëjnë ato pjesë të aktivitetit të tyre.

Në përfundim të aktivitetit u shpërndanë edhe çmimet përkatëse:

“**SmartCharging**” fitoi çmimin e parë, i cili përfshinte dy bileta për në Festivalin e Pionierëve, që do të mbahet me 28-29 Maj 2015 në Vjenë dhe një Program Mentorimi nga Albanian Innovation Accelerator.

“**PartyON**” fitoi çmimin e dytë.

“**Rest.al**” fitoi çmimin e tretë.

“**Share Albania**” fitoi çmimi AIDA prej 300 000 lekësh.

Tri vendet e para morën gjithashtu një çmim nga YUNUS SOCIAL BUSINESS ALBANIA që përbëhej nga një program Akselerimi 4-mujor për bizneset.

Ndërkohë në kuadër Javës së Inovacionit, organizuar nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, AMC dhe Deutsche Telekom shpallen fituesin e “Konkursit të Inovacionit”, përzgjedhur ndër 45 aplikimet e bëra përgjatë një muaji. Një juri ekspertësh e përbërë nga përfaqësues të AMC, Deutsche Telekom, Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike, si dhe kompanive Cisco dhe Intel vlerësuan si më të mirën idenë “BDF Health”. Ky projekt u krijua nga katër inovatorë të rinj, me qëllim pakësimin e stresit dhe lodhjes pas orëve të gjata të punës apo studimit. Juria zgjodhi dhe 10 projektet më të mira të cilat do të vazhdonin më tej në konkurimin në Challenge Up, që zhvillohet çdo vit nga Deutsche Telekom dhe Hub:raum. Duke marrë fjalën në ceremoninë e organizuar me këtë rast Ministrja e Shtetit, Milena Harito u shpreh:

“Kam kënaqësinë që ky aktivitet po zhvillohet në kuadër të Javës së Inovacionit dhe ka nisur praktikisht që prej ditës së diel me një numër shumë të madh eventesh. Veçanërisht kënaqësi, sepse aktivitetet që kanë të bëjnë me kompetitivitetin e të rinjve në fushën e inovacionit janë ato që janë njëkohësisht më interesantet, më të vështirat, por edhe më të rëndësishmet. Programi i Qeverisë sonë për modernizimin e shoqërisë, i cili kalon nëpërmjet teknologjisë, mbështetet në **katër shtylla** shumë koherente me njëra-tjetrën, të cilat janë: Në **radhë të parë modernizimi i qeverisjes**, pra i gjithë institucioneve të shtetit dhe këtu kemi një program të tërë me investime të trefishuara në këto 18 muaj, me burime njerëzore të mëdha. Pra, kemi arritur rezultate shumë konkrete në pjesën e parë, që është modernizimi i shtetit.

Shtylla e dytë ka të bëjë me telekomunikacionet dhe është kënaqësi që ky aktivitet organizohet nga Deutsche Telecom dhe AMC, sepse ka të bëjë me aksesibilitetin. I gjithë modernizimi i shtetit përmes teknologjisë ka të bëjë me shërbimet, ku një pjesë e tyre janë tashmë online, por e gjithë kjo nuk bën sens nëse nuk ka aksesibilitet të mjaftueshëm, pra nëse telekomunikacionet nuk zhvillohen ashtu siç duhet. Më e fundit ndër arritjet në fushën e telekomunikacioneve është dhënia e mundësisë për të futur teknologjinë 4G në Shqipëri.

Shtylla e tretë është rritja e kapaciteteve të rinisë sonë, sidomos nëpërmjet arsimit, programi E-learning, përfshirja e tabletave nëpër shkollë, të cilat janë duke u ndjekur në mënyrë shumë të vendosur nga Ministria e Arsimit. S

Shtylla e katërt, në të vërtetë nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me shtetin dhe qeverisjen, por ka të bëjë me zhvillimin e shoqërisë dhe punësimin e rinisë. Në këtë pikë, shteti dhe qeveria kanë një rol nxitës, por lëvizja ndodh në shoqëri dhe ju jeni prova më e mirë; kompeticione si ky janë prova më e mirë që kjo lëvizje është duke ndodhur dhe gjatë kësaj jave kemi jo më pak se tri aktivitete shumë intensive që kanë të bëjnë me konkurrencën e të rinjve në fushën e teknologjisë së informacionit.

Për ju të rinj kam një pyetje: A e njihni Natev dhe a keni votuar për të? Shoh disa shenja pohimi nga ana juaj. Natev është një start-up i vogël nga Kosova, i cili sapo ka fituar një kompeticion të organizuar nga NASA, ku morën pjesë 133 shtete, 950 projekte dhe start-up i Kosovës doli i pari në botë. Nëse do të ishte nevoja edhe për një provë tjetër, që teknologjia nuk njeh kufij, nuk ka lidhje me madhësinë e shteteve, ka lidhje vetëm me dëshirën, vullnetin dhe energjinë për të ecur përpara.

Ju falënderoj që keni marrë pjesë në këtë konkurs! Jam e bindur se pak rëndësi ka se kush janë fituesit. Fakti që ju keni marrë pjesë tregon që ju jeni në rrugën e duhur, ju jeni në drejtimin e duhur dhe ju inkurajoj të vazhdoni e të merrni pjesë në shumë e shumë konkurse të tjera dhe t'i ktheni idetë tuaja në biznese të suksesshme”.

Nga ana tjetër si pjesë e aktiviteteve të Javës së Inovacionit 2015, Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike zj. Milena Harito , , organizoi në bashkëpunim me Tirana Expo Centre dhe me mbështetjen e partnerëve strategjike, UNDP, Vizion Plus dhe Societe Generale Albania, Panairin "High Tech Shoë" 11-13 Maj 2015. Është hera e parë që një panair i këtij lloji me produkte dhe shërbime inovative në fushën e komunikimin dhe Teknologjisë së Informacionit u zhvillua në vendin tonë. Në panair morën pjesë 64 kompani private, institucione shtetërore si dhe universitete të fushës teknologjisë së Informacionit. Në Panairin "High Tech Shoë" për herë të parë u prezantuan një sërë shërbimesh publike të dixhitalizuara dhe informatizuara që e bëjnë më efçente punën e strukturave dhe agjensive shtetërore si dhe rrisin ndjeshëm cilësinë e shërbimit dhe transparencën ndaj qytetarëve. Kështu në të ekspozuan shërbimet e tyre të digjitalizuara Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore, Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe ajo e Doganave, Qendra e Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), etj. Risia e dytë dhe po aq e rëndësishme e këtij panairi ishte se në të u prezantuan edhe një numër i Universitetesh të ndryshme të fushës së komunikimit dhe teknologjisë së Informacionit. Gjithashtu, në këtë panair u prezantuan produkte dhe shërbime inovative disa start-up nga Prishtina falë mbështetjes së Innovation Centre Kosovo (ICK).

Ministrja e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, zj Milena Harito në ceremoninë e zhvilluar në çelje të panairit theksoi: "Në këto 18 muaj, inovacioni ka qenë një ndër kryefjalët e përpjekjes sonë për modernizimin e shtetit në radhë të parë, si një mjet për të rritur efikasitetin në punë të gjithë administratës, duke futur sistemet e dixhitalizuara për të lehtësuar proceset e punës, për të kontrolluar dhe monitoruar rezultatet dhe për të luftuar sigurisht korrupsionin, që mbetet një gangrenë e shoqërisë sonë, por edhe në përgjithësi e shoqërive në zhvillim". Panairi "High Tech Show" qëndroi i hapur për publikun nga data 11 deri më 13 maj.

JAVA E INOVACIONIT 2014



Nga data 10 Maj-16 Maj 2014, u cel zyrtarisht Java e Inovacionit e cila u organizua për herë të parë në Shqipëri nga Ministri për Inovacionin dhe Administratën Publike, znj. Milena Harito.

Në hapjen e kësaj jave, morën pjesë edhe Zv.Kryeministri z. Niko Peleshi, Ministrja e Arsimit e Sportit znj. Lindita Nikolla dhe përfaqësues të agjencive e institucioneve specifike të fushës së Inovacionit në Shqipëri. “Ngritja e sistemeve të ndërthurura të cilat bëjnë të pamundur që gjërat të manipulohen, bën që njerëzit të kenë besim tek njëri-tjetri, besim tek shteti dhe si rrjedhojë edhe besim tek e ardhmja.” – me këtë çështje nisi fjalën e saj Ministrja Harito, duke iu referuar transparencës që ofron teknologjia, si faktor i rëndësishëm për krijimin e klimës së besimit. Gjithashtu, Ministrja Harito duke folur mbi vështirësitë që mund të hasen në përdorimin e teknologjisë, theksoi se teknologjia më e mirë por edhe më e vështira për tu realizuar është ajo që u mundëson qytetarëve një përdorim sa më të thjeshtë. Duke përmendur kështu shërbimet online të cilat jo vetëm thjeshtojnë proceset e shërbimeve, por edhe mundësojnë shmangien e korrupsionit. Java e Inovacionit, ndër të tjera solli për publikun, portalin e Informacionit Gjeohapësinor, i cil përmban të dhëna të hapura dhe do të shërbejë si referencë unike e hartave të shtetit shqiptar. Mbi këtë çështje, Ministrja Harito tha se “Ky portal është baza teknologjike e nevojshme për të zgjidhur problemin jashtëzakonisht të madh, të pronësisë. që kemi në Shqipëri. Sigurisht kjo nuk mjafton për ta zgjidhur, por është kusht i nevojshëm për zgjidhjen e tij”

Nga ana tjetër inovacioni në arsim, sportelet unike në shërbimet e policisë me anë të One Stop Shop-it që lehtëson marrjen e shërbimit nga ana e njerëzve, pagesat e faturave me anë të telefonisë celulare, ishin disa nga projektet e tjera, të cilat u prezantohen nëpër aktivitetet e Javës së Inovacionit.

Por njëkohësisht kjo javë shërbeu edhe për të promovuar e energjizuar gjithë sektorin, që nga takimet me operatorët e telekomunikacionit, të cilët përfaqesojnë jo vetëm 5% të GDP së Shqipërisë, por kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe në punësimin e inxhinjerëve të rinj, deri tek projektet e të rinjve inovatore

Në kuadër të bashkëpunimit me biznesin e teknologjive të komunikimit Albtelecom mbështeti një sërë aktivitetesh të organizuara në kuadër të 'Javës së Inovacionit'. Konferenca 'Broadband për një Zhvillim të Qëndrueshëm' mbledhi së bashku Ministren e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike znj. Milena Harito, përfaqësuesit e lartë të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si dhe përfaqësues të kompanive të telekomunikacionit në vend si ALBtelecom dhe Eagle Mobile, Vodafone Albania, AMC dhe PLUS Communications, të cilët hodhën dritë mbi zhvillimet në tregun e telekomunikacionit. Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom dhe Eagle Mobile, Dr. Erkan Tabak foli për rëndësinë e Broadband-it si çelësi i revolucionit në teknologji, si dhe për investimet e mëdha që kjo kompani ka bërë në këtë drejtim. Në fjalën e tij Dr. Tabak u shpreh se: "ALBtelecom e konsideron si prioritetin e saj kryesor përmbushjen e vazhdueshme të kërkesës në rritje për shërbimet e telekomunikacionit. Prandaj ne besojmë në rëndësinë e madhe të broadband-it dhe investimeve për të. Investimet tona i përfshijnë të dy rrjetet, si atë të telefonisë fikse ashtu edhe atë të telefonisë mobile". Ndërkohë, gjatë 'Javës së Inovacionit' ALBtelecom ishte sponsori Gold i konkursit "KODE – Të Dhëna Qeveritare në Dorën Tuaj", organizuar me kontributin e Qendrës PROTİK, AKSHI-t dhe Ministres së Inovacionit dhe Administratës Publike, Objektivi kryesor i këtij konkursi ishte "rritja e transparencës dhe e përgjegjësive të institucioneve shtetërore", duke nxitur përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit për menaxhimin e të dhënave qeveritare. Konkursi për përdorimin e të dhënave qeveritare: synonte që ato të dhëna që ekzistojnë sot në faqet tona në Internet, por që perdoren shumë pak nga qytetarët. studentët ti shndërronin në koncepte të aplikimeve facebook ose Website, të cilat thjesht transformojnë të dhënat ekzistuese në një format lehtësisht të përdorshëm. Studentëve fitues të këtij konkursi iu shpërnadnë si dhuratë IpadAir nga Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom dhe Eagle Mobile, Dr. Erkan Tabak. Të pranishme në këtë aktivitet ishin Ministria Harito dhe Drejtoresha e Qendrës PROTİK znj.

Edlira Kasaj. Një tjetër aktivitet i rëndësishëm ka qenë edhe ai i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, ku ALBtelecom ka dhuruar kompjuterë për laboratorin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve të kësaj shkolle – Gjatë këtij aktiviteti Drejtori i Grupit të Teknologjisë së Informacionit dhe njëkohësisht Zv. Drejtori i Përgjithshëm i ALBtelecom z. Vahap Yeroglu tha se ALBtelecom i jep rëndësi të veçantë projekteve të tilla, pasi teknologjia është gjithmonë në plan të parë për ALBtelecom, duke nënvizuar edhe rëndësinë e të gjitha projekteve sociale të kësaj kompanie, krahas investimeve që ajo ka bërë –

Në ditën e fundit të Javës së Inovacionit më 16 Maj 2014 , në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar u organizua një ceremoni përmbyllëse. Në fjalën e saj zj, Milena Harito përmendi faktin se “Kjo javë na shterbeu për të sjellë në fokus inovacionin si një nga prioritetet e qeverisë tonë, si një mjet për të modernizuar administratën, për të përmirësuar shërbimet publike, për të sjellë progres për të gjithë shoqërinë”. Gjatë Javës së Inovacionit u demonstruan publikisht disa rezultate shumë konkrete si:

1) Krijimi e nje portali të hapur që do të jetë referenca e vetme zyrtare e të dheneve gjeohapësinore. Ky portal është baza e nevojshme teknike për të zgjidhur plagën e mbivendosjes së pronave si dhe korrupsionin e lidhur me një informacion gjeohapësinor të cunguar. Sipas ministres Harito “ Hartat që shiteshin nën dorë, që ishin të ndryshme në cdo institucion, sot janë të disponueshme për të gjithë dhe gjithashtu të verifikueshme.Konstatojme që historikisht ato kanë pësuar shumë mbivendosje, ndaj në muajt në vijim do të punojmë pikërisht për të krijuar nje referencë unike që do ta evitojë këtë problem.

Ndërkohë një element tjetër inovativ ishte prezantimi i :

2) Pagesave të faturave të CEZ me celular- dhe kur themi me celular, nënkuptohet një celular të thjeshtë, jo vetëm me smartphone apo nëpërmjet Internetit. Kjo do të lehtësojë ndjeshëm pagesat, do të evitojë abuzimet në sportele, duke hapur luftë të drejtëpërdrejtë korrupsionit. Shumë shpejt kjo gjë do të bëhet e mundur edhe për gjambat e policisë.

3) Nënshkrimi elektronik i dokumentave, një bashkepunim i autoritetit për certifikimin elektronik dhe qendrës së regjistrimit të biznesit – për t'i lehtësuar jetën biznesit dhe për të evituar kërkesat për dokumenta, kur ato mund të transmetohen drejtpërdrejt në formate elektronike.

Nga ana tjetër gjatë kësaj jave u inaugurua një :

4) Qendër certifikimi të njohurive për administratën publike në italisht dhe në anglisht. Certifikimi realizohet në menyrë dixhitale dhe sipas standarteve europiane, domosdoshmëri kjo për të ngritur një sistem vlerësimi objektiv për administratën. Në fusha të tjera të shërbimeve publike u evidentuan një sërë projektesh me karakter inovativ që lehtësojnë jetën e qytetarëve e rrisin cilësinë e shërbimeve. Kështu psh 3 spitale të reja ju bashkuan rrjetit kombëtar të telemjekësisë në Vlorë, Korçë, Gjirokastër dhe lista e barnave të rimbursueshme është e disponueshme në Internet që nga muaji prill 2014. Zbatimi i Projektit për dixhitalizimin e Ndihmës Ekonomike, në zyrën e Fushë Krujës projekt që njihet me emrin «Shqiperia solidare »

Ministria Harito ngriti shqetësimin lidhur me nivelin e informimit dhe zgjerimin e përdorimit të shërbimeve publike nga qytetarët që tashmë ofrohen përmes formave të reja që mundëson teknologjia e informacionit . Në fjalën e saj ajo përmendi rastin e portalit të shërbimeve publike e-Albania “ Nuk di nëse ju e njihni portalin e shërbimeve publike e-Albania.Në fakt është një nga momentet e mia të vetmisë së madhe, kur shkoj nëpër universitete të promovoj projektet në fushën e TIK dhe pyes se sa vetë e njohin dhe përdorin këtë portal. Në salla me 100 vetë, zakonisht vetëm 4-5 duar ngrihen për të thënë që e njohin atë. Dhe jo më kot. Portali është ende sot një portal I tipit Web 1.0, ashtu sic ishin portalet 5-10 vjet më parë, kryesisht me shërbime të tipit informativ, dhe me shumë pak shërbime të tipit Web2.0 pra shërbime interaktive. Pra një nga detyrat konkrete që ka marrë përsipër Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, është të rrisë numrin e shërbimeve interaktive, disa prej të cilëve janë realizuar tashmë, shërbime të cilat u evitojnë qytetarëve të shkojnë në sportele, dhe në këtë mënyrë synojnë të rrisin numrin e përdoruesve online. Ky është një rezultat I matshëm, që do të jetë i dukshëm në muajt në vazhdim.”

Në vazhdim , u përmendën edhe projekte të tjera që po zbatohen në këtë fushë si psh “One Stop Shop” për shërbimet e policisë dhe doganat, të cilat lehtësojnë punën , shkurtojnë kohën, bëjnë transparente shërbimet në sportel. Ndërmjet të tjerash u theksua se këto dy projekte janë vetëm në hapat e parë drejt një projekti më madhor, mbi qendrën unike të shërbimeve publike për qytetarët, e cila po përgatitet në bashkepunim me partnerët, si pjesë e përmirësimit të qeverisjes.

Zj.Harito theksoi se hovi që duam të ndërrmarim në fushën e dixhitalizimit, nuk do të jetë i qendrueshëm në kohë, pa një konsolidim e përforsim të vazhdueshëm të kapaciteteve. Java e Inovacionit 2014 ishte një dëshmi ku u vlerësua teknologjia e inovacionin si një mjet për të krijuar besueshmëri, duke rritur transparencën dhe efektivitetin e shërbimeve të ndryshme.